




**Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial
Council**

Duke u bazuar në nenin 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit (dhe Planin për Implementimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (tani e tutje "KPK") miraton:

**R R E G U L L O R E Nr. 7/2012
PËR CAKTIMIN DHE TRANSFERIMIN E PROKURORËVE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë rregullore caktohen kriteret dhe procedurat për caktimin dhe transferimin e Prokurorëve, duke u bazuar në riorganizimin e Prokurorive të përcaktuar me Ligjin për Prokurorin e Shtetit (tani e tutje "Ligji").
2. Për qëllim të kësaj rregullore kalimi i prokurorëve të prokurorive të qarkut në atë të apelit do të konsiderohet transferim.

**Neni 2
Parimet bazë**

1. Gjatë caktimit dhe transferimit të prokurorëve, KPK do të udhëhiqet nga parimet si në vijim:
 - 1.1. Respektimi i shumëllojshmërisë etnike (Neni 5 i Ligjit);
 - 1.2. Parimet ndërkombëtare të barazisë gjinore (Neni 5); dhe
 - 1.3. Përfshirjen gjeografike.

**Neni 3
Organizimi i Prokurorive**

1. Sipas Ligjit, Prokuroritë e Republikës së Kosovës nga data 01 janar 2013 organizohen si në vijim:

- 1.1 Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- 1.2. Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- 1.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës; dhe
- 1.4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 4

Kriteret për caktimin dhe transferimin e Prokurorëve

1. Gjatë fazës së implementimit të ligjit, prokurorët mund të caktohen dhe transferohen vetëm në bazë të kriterëve të parapara me këtë rregullore.
2. Përveç kualifikimeve minimale, prokurorët që plotësojnë kushtet në vijim do të jenë kandidat potencial për caktim dhe transferim:
 - 2.1 Për Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore prokurori duhet të ketë ushtruar së paku tri vjet detyrën e prokurorit apo gjyqtarit;
 - 2.2 Për Prokurorinë e Apelit prokurori duhet të ketë ushtruar së paku katër vite detyrën e prokurorit apo gjyqtarit.

Neni 5

Caktimi dhe Transferimi

1. Gjatë caktimit të prokurorëve në fazën e implementimit të Ligjit, KPK do të marrë parasysh dhe jap rëndësinë e duhur emërimeve gjatë procesit gjithëpërfshirës të riemërimit (Neni 28, par. 2.4 i Ligjit).
2. KPK do të respektojë vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit dhe transferimit përveç kur kjo është e domosdoshme për të siguruar dhe lehtësuar fazën kalimtare nga organizimi aktual në organizmin e ri sipas ligjit.
3. KPK do të sigurohet, që çdoherë kur të jetë e mundur, të caktojë prokurorët brenda vendndodhjes së tyre gjeografike.
4. Prokurorët në detyrë në Prokuroritë komunale, në parim, do të sistemohen në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore.
5. Prokurorët në detyrë në Prokuroritë e Qarkut në parim, do të caktohen në Departamentet e Specializuara të Prokurorisë Themelore bazuar në përvojën dhe fushën e tyre të specializimit.
6. KPK mund të transferojë një prokuror nga një prokurori e nivelit më të lartë në prokurori të nivelit më të ulët vetëm me kërkesën e prokurorit.
7. Vendimin për caktim dhe transferim të prokurorëve e merr KPK bazuar në rekomandimin e Komisionit sipas Nenit 9 të kësaj Rregullore.

8. Për qëllim të kësaj rregulloreje departamente të specializuara konsiderohen departamenti për krime të rënda dhe departamenti për të mitur.
9. Prokurori i një prokurorie mund të transferohet, nga prokurori në Departamentin e Përgjithshëm në detyrën e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda, me kusht që ti plotësojë kushtet e parapara për emërim për prokuror në Departamentin e caktuar.
10. Bazuar në kriteret e miratuara dhe duke pasur parasysh shprehjen e interesimit nga ana e prokurorëve, KPK, në baza meritore, cakton prokurorët e qarkut në Departamentet përkatëse të Prokurorisë së Apelit.
11. Në rast se numri i prokurorëve në Prokurorinë e Apelit nuk do të plotësohet me prokurorët aktual të qarkut, KPK u ofron mundësinë për transferim në Prokurorinë e Apelit prokurorëve tjerë aktual të cilët i plotësojnë kriteret për tu caktuar në Prokurorinë e Apelit me ç'rast merr parasysh edhe kriteret shtese të parapara me këtë rregullore.

Neni 6 **Kompletimi i dosjeve**

1. Njësitë për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorëve i paraqet Komisionit të dhënat mbi:

- 1.1. Rezultatet e Punës dhe pershkrimi vlerësues i Kryeprokurorit;
- 1.2. Përvojën e punës;
- 1.3. Trajnimet profesionale dhe akademike të ndjekura-arsimimi i vazhdueshëm ligjor;
- 1.4. Publikimet-Punimet shkencore; mirenjohjet,
- 1.5. Specializimi në lëmi të caktuar.
- 1.6. Njohuritë mbi përdorimin e teknologjisë informative
- 1.7. Masat disiplinore të marra ndaj prokurorit;
- 1.8. Të dhënat tjera që konsiderohen të jenë relevante.

Neni 7 **Procedura**

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj Rregulloreje, KPK themelon Komision për caktimin dhe transferimin e Prokurorëve në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore.
2. KPK, shpall njoftim të brendshëm me të cilin do të ofrohet mundësia të gjithë prokurorëve në nivel të Shtetit për të shprehur interesimin e tyre për të aplikuar për caktim dhe transferim.
3. Me rastin e aplikimit, prokurorët duhet të përcaktohen se në cilin Departament apo Prokurori janë të interesuar që të caktohen apo transferohen.
4. Prokurorët mund të bashkangjesin të dhënat që disponojnë për rezultatet e punës.

5. Prokurorëve që emërohen në pozitat e tyre pas përfundimit të afatit për aplikim për caktim apo transferim, KPK do të jap mundësinë për aplikim në një datë të mëvonshme.

Neni 8 Përbërja e Komisionit

1. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Kryeprokurori i Shtetit, kryetar i Komisionit;
 - 1.2. Një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, anëtar;
 - 1.3. Nje përfaqësues nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Një prokuror nga prokuroria Speciale, anëtar;
 - 1.4. Nje anetare nga anëtarët jo prokurorë të KPK, duke përjashtuar Ministrin e Drejtësisë.
2. Komisioni do të ketë kuorum kur të pranishëm janë së paku katër anëtarë.
3. Komisioni do të marr Vendim nga kuorumi jo me pak se tre vota “për”.
4. Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare.

Neni 9 Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni shqyrton të gjitha aplikacionet e paraqitura në bazë të shpalljes së brendshme.
2. Komisioni shqyrton të gjitha të dhënat e ofruara nga Njesiti për Shqyrtimin e Performances.
3. Pas konstatimit se kriteret ligjore nga Neni 4 i kësaj Rregullore janë plotësuar, për qëllime të transferimit të prokurorëve komunal në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore, Komisioni do të aplikojë edhe kriteret e mëposhtme vlerësuese:

Kriteret	Piket
Pervoja e punës:	
Pervoja si prokuror apo gjyqtar në nivel komunal cdo vit pervoje pune nga 0.5 pike, maksimumi 3 pike	0.5-3
Pervoje si prokuror apo gjyqtar i qarkut apo kryeprokuror i prokurorisë komunale apo kryetar i gjykatës komunale cdo vit pervoje pune 0.5 pike; maksimumi 3 pike;	0.5-3
Pervoje pune si kryeprokuror i Prokurorisë së qarkut apo kryetar i gjykatës së qarkut, prokuror i PSRK cdo vit pervoje pune 0.5 pike, maksimumi, maksimumi 3 pike;	0.5-3

Rezultatet e punës-Tejkalimi i normës gjate gjashte mujorit te dyte te vitit 2011 ¹² , 10% 1 pike, 20 % 3 pike, 30 % 5 pike, 40% 7 pike, dhe mbi 50 % 10 pike maksimumi.	1-10
Pershkrimi vlerësues i Kryeprokurorit maksimumi 10 pike, Mjaftueshëm (1) pike Knaqshem (3) pike Mire (5) pike Shume mire (7) pike Shkelqyeshem (10) pike	1-10
Trajnimet profesionale dhe akademike te ndjekura, arsimimi i vazhdueshëm ligjor; 1 pike	1
Njohurite mbi përdorimin e teknologjisë informative 1 pike	1
Masa disiplinore te shqiptuara ndaj prokurorit Qortim minus 1 pike Verejtje minus 2 pike Ulja e pagës minus 3 pike	Minus 3 deri minus 1

4. Pas konstatimit se kriteret ligjore nga Neni 4 i kësaj Rregullore janë plotësuar, për qëllime të caktimit dhe transferimit të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit dhe Departmentet përkatëse të saj, Komisioni do të aplikojë edhe kriteret e mëposhtme vlerësuese:

Kriteret	Piket
Pervoja e punës: Pervoja si prokuror apo gjyqtar ne nivel komunal cdo vit pervoje pune nga 0.5 pike; maksimumi 3 pike;	0.5-3
Përvoje si prokuror apo gjyqtar i qarkut, i PSRK apo kryeprokuror i prokurorisë komunale apo kryetar i gjykatës komunale cdo vit pervoje pune 1 pike; maksimumi 6 pike;	1-6
Rezultatet e punës-Tejkalimi i normës gjate gjashte mujorit te dyte te vitit 2011 ³⁴ , 10% 1 pike, 20 % 3 pike, 30 % 5 pike, 40% 7 pike, dhe mbi 50 % 10 pike maksimumi.	1-10
Pershkrimi vlerësues i Kryeprokurorit , Mjaftueshëm (1) pike	

¹ Prokuroria Speciale e Republikes se Kosoves, Prokuroria e Qarkut dhe ajo komunale ne Mirovice, prokuroret e emeruar gjate vitit 2011 dhe 2012 dhe prokuroret qe punojne ne rastet e korrupsionit do te konsiderohen se e kane plotesuar normen, perveq nese jane vleresuar me vleresim negative nga Kryeprokurori I Prokurorise perkatese

² Kryeprokurori I Prokurorise perkatese do te vleresohet ne baze vleresimit te prokurorise qe ai udheheq

³ Prokuroria Speciale e Republikes se Kosoves, Prokuroria e Qarkut dhe ajo komunale ne Mirovice, prokuroret e emeruar gjate vitit 2011 dhe 2012 dhe prokuroret qe punojne ne rastet e korrupsionit do te konsiderohen se e kane plotesuar normen, perveq nese jane vleresuar me vleresim negative nga Kryeprokurori I Prokurorise perkatese

⁴ Kryeprokurori I Prokurorise perkatese do te vleresohet ne baze vleresimit te prokurorise qe ai udheheq

Knaqshem (3) pike Mire (5) pike Shume mire (7) pike Shkëlqyeshem (10) pike	1-10
Trajnimet profesionale dhe akademike te ndjekura, arsimimi i vazhdueshëm ligjor; 1 pike	1
Njohurite mbi përdorimin e teknologjisë informative 1 pike	1
Masa disiplinore te shqiptuara nga KPK ndaj prokurorit Qortim minus 1 pike Verejtje minus 2 pike Ulja e pagës minus 3 pike	Minus 3 deri minus 1

5. Kriteret për caktimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit janë:

Kriteret	Pikët
Ushtrimi i funksionit të Kryeprokurorit Komunal (për secilin vjet të përvojës së punës 1 pikë por jo më shumë se 3 pikë)	1-3
Përvoja pune si kryeprokuror i Prokurorisë së qarkut apo kryetar i gjykatës së qarkut, zëvendeskryeprokuror i PSRK cdo vit përvojë pune 2 pike, maksimumi 12	2-12
Përvoja si prokuror i qarkut për së paku 5 vite	2

6. Kriteret për caktimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore janë:

Kriteret	Pikët
Ushtrimi i funksionit të Kryeprokurorit Komunal (për secilin vjet të përvojës së punës 1 pikë por jo më shumë se 3 pikë)	1-3
Ushtrimi i funksionit të Kryeprokurorit të Qarkut (për secilin vjet të përvojës së punës 2 pikë por jo më shumë se 6 pikë)	2-6
Përvoja si prokuror komunale se paku 4 vite apo si prokuror i qarkut për së paku 3 vite	2

7. Komisioni mund të kërkoj informata shtesë nga prokurori apo nga Njësiti.
8. Prokurorit ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore ulje e pagës, gjatë kohës sa kjo masë aplikohet nuk ka të drejtë avancimi në një pozite më të lartë.
9. Komisioni ka për detyrë që deri më datën 31 tetor 2012 t'ia paraqes KPK-se listën përfundimtare të prokurorëve të propozuar për caktim apo transferim.
10. KPK duhet që deri me datën 8 nëntor 2012 të merr Vendim për caktim apo transferim të prokurorëve. Vendimi i KPK-së do të publikohet.

Neni 10
Rishqyrtimi nga KPK

1. Në rastet kur ndonjë prokuror do të paraqes kërkesë për rishqyrtim mbi bazat e caktuara në paragrafin (2) të këtij Neni, KPK do të rishqyrtojë vendimin e vet.
2. Një prokuror mund të kërkojë që KPK të rishqyrtojë vendimin e vet për transferim të tij apo saj në një pozitë të caktuar nëse:
 - 2.1 Ajo pozitë nuk është njëra nga pozitat për të cilat ka aplikuar prokurori; dhe
 - 2.2 Transferimi në atë lokacion do të shkaktonte prokurorit vështirësi tej mase.
3. Kërkesa për rishqyrtim sipas këtij neni do të bëhet me shkrim dhe dorëzohet brenda 7 ditëve (kalendarike) nga data e publikimit të vendimit të KPK-së.
4. Në rast të dorëzimit të kërkesës në pajtim me këtë nen, KPK do të rishqyrtojë vendimin e vet brenda 10 ditëve (kalendarike). Prokurori që ka parashtruar kërkesën do të njoftohet menjëherë me shkrim për vendimin.
5. Nëse procesi i rishqyrtimit ka rezultuar në ndryshim të vendimit të KPK-së mbi caktimin dhe transferimin e prokurorëve, KPK do të publikojë vendimin e ndryshuar.

Neni 11
Emërimi i Kryeprokurorëve nga ana e KPK-së

Pas publikimit të vendimit të KPK-së mbi caktimin dhe transferimin e prokurorëve, KPK do të publikojë njoftim të brendshëm për konkurim për pozitën e Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse.

Prokurorët nga prokuroritë përkatëse do të kenë mundësinë të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit në prokurorinë në të cilën janë caktuar apo transferuar.

Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse do të emërohet në mesin e prokurorëve të caktuar apo transferuar në atë prokurori.

Neni 12
Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datën 28 shtator 2012.


Ismet Kabashi
Kryetari i Këshillit Prokurorial